



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:224748

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05715456

P.nr.299/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve S.D dhe E.D, për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare nga neni 140 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje e KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 2174/22 të datës 27.10.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë **25.03.2024**, në praninë e prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurve S.D dhe E.D, si dhe përkthyesit të gjykatës Zenel Fetahaj, nga gjuha shqipe ne gjuhën serbe dhe anasjelltas, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 22.04.2024, përpiloi këtë

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

- 1. S.D** nga i ati M., i lindur me datë ... në Koprivina Bijeje Polje në Republikën e Serbisë, tani me vendbanim në fshatin D., Komuna I., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr. ... boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. E.D**, nga i ati M., i lindur me datë në Koprivina Bijeje Polje në Republikën e Serbisë, tani me vendbanim në fshatin D., Komuna I., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ... boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datën 13.10.2022, rreth 19:00 në Bjeshkët e Moknës, Komuna Istog, kalojnë kufirin nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës, jashtë vendkalimit të autorizuar kufitar, duke shmangur pikën e kontrollit kufitarë “Kulla” në atë mënyrë që, gjersa zyrtarët e policisë kufitare-Radave, ishin në patrullim në bjeshkën e Moknës, vërejnë veturën e markës “Mercedes 310D”, ngjyrë të bardhë, me targa të Republikës së Serbisë SJ-012-TL, të cilën veturë e drejtonte këtu i pandehuri E.D dhe se bashku me të në veturë ishte këtu i pandehuri S.D, njëherë edhe pronar i veturës, të njëjtit ndalohen nga policia e Kosovës, pasi me veprimet e tyre secili veç e veç kanë përmbushur elementet e veprës kalimi i pa autorizuar i vendkalimit kufitar.

- me çka kanë kryer veprën penale **kalimi i paautorizuar i vendkalimeve nga neni 140 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70 të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit **S.D** i shqiptohet **dënim me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro**, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Ashtu që, të pandehurit **E.D** i shqiptohet **dënim me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro**, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
 - Nëse të pandehurit nuk mundën apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku çdo njëzet (20) euro të gjobës, do të ju llogariten me një (1) ditë burgim.
- III.** Sendet të cilat kanë qenë të sekuestruara në këtë çështje penale nga Stacioni Policor Kufitar Vitomericë, sipas vërtetimit për sekuestrim me numër të rastit 2022-YWA-099 të datës 13.10.2022. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse të njëjtat sende nuk i duhen prokurorisë si prova për ndonjë çështje tjetër penale ndaj këtij të pandehuri, atëherë të njëjtat sende institucioni i cili i ka në posedim apo institucioni i cili i ka konfiskuar, duhet të i'a kthej pronarit - këtu të pandehurit E.D.
- IV.** **OBLIGOHEN** të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor, shumën nga **njëzetë (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën nga **njëzetë (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Palë të dëmtuar, nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 2174/22 të datës 27.10.2022, kundër të pandehurve S.D dhe E.D, për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së. Të cilit cilësim juridik prokurori i shtetit ne seancën e shqyrtimit fillestar i'a ka shtuar edhe nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 25.03.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit S.D dhe E.D, si dhe përkthyesi i gjykatës Zenel Fetahaj përkthyes nga gjuha shqipe ne gjuhën serbe dhe anasjelltas. Ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, pastaj gjykata pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ju ka mundësuar të pandehurve të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri S.D, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se jam penduar për këto veprime dhe i premtom gjykatës se ne të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

I pandehuri E.D ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtom gjykatës se ne të ardhmen nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të pandehurit S.D dhe E.D për veprën penale për të cilën akuzohen, andaj kërkojmë që ky pranim fajësie të aprovohet si i tillë.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pas marrjes së mendimeve te lartcekura nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprën penale të lartcekur për te cilën janë akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjti janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që për të pandehurin **S.D** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është i moshës së shtyrë, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur; për të pandehurin **E.D**, si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, të cilët do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për sendet të cilat kanë qenë të sekuestruara nga policia në këtë çështje penale

Gjykata duke vepruar konform nenit 113 të KPP-së, pasi që vërtetoi se në shkresat të lëndës gjendet një vërtetim mbi konfiskimin e sendeve me numër të rastit 2022-YWA-099 të datës 13.10.2022, sipas të cilit Stacioni Policor Kufitar Vitomericë, nga i pandehuri E.D, ditën kritike, ka konfiskuar një Kombi Mercedes me numër të tabelave SJ012TL; dhe disa sende të cilat kanë qenë në këtë kombi. Mirpo të njëjtat sende nuk kanë qenë të specifikuar që të konfiskohen në këtë çështje penale, po ashtu gjykata nuk ka gjetur se këto sende kanë të bëjnë me objektin e veprës penale e cila ju vihet në barrë të pandehurve në këtë çështje penale, rrjedhimisht nuk ka bazë për konfiskimin e tyre nga gjykata në këtë çështje penale. Prandaj gjykata urdhëroi që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të bëhet verifikimi në prokurori, ashtu që, nëse të këto sende prokurorisë i duhen si prova për ndonjë çështje tjetër penale në raport me të pandehurin E.D Mirëpo nëse të njëjtat sende vërtetohet nga prokuroria se, nuk i duhen prokurorisë për ndonjë veprë tjetër penale si prova, atëherë të njëjtat siç janë të listuara në vërtetimin e lartcekur 2022-

YWA-099 të datës 13.10.2022, duhet ti kthehen pronarit – këtu të pandehurit E.D, nga i cili janë sekuestruar.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, i ngarkoi të akuzuarit me shpenzimet e procedurës të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i obligoi të paguajnë shumën nga 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*